



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:090025
Datë: 22.01.2024
Numri i dokumentit: 05221064

PA1.nr.1494/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Pergjithshem, kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Arben Arifi si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.H., nga fshati..., K. Prizren, për shkak të veprës penale Detyrimi nga neni 340 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtëses së akuzuarit, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1076/2020 datë 18.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20.Dhjetor.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

Me **APROVIMIN** e ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit V.H., **ANULOHET** aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1076/2020 datë 18.09.2023, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1076/2020 datë 18.09.2023, i akuzuari **V.H.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Detyrimi nga neni 340 par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgin në kohëzgjatje prej 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) ditëve e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koka e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 14.11.2015 deri me datë 26.09.2016, si dhe dënim me gjobe në shumë prej 1,500 (njëmijë e pesëqind) euro e të cilën gjobe është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po me të njëjtin aktgjykim e në bazë të nenit 62 të KPRK-së i akuzuari është urdhëruar që të dëmtuarit B.K. të ia kompensojë dëmin në shumë prej 2,500 (dymijë e pesëqind) euro në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet) euro si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20 (njëzet) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë të ndryshoj dhe të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor t'i shqiptoj dënim më të lartë me burgim.

Mbrojtësja e të akuzuarit V.H., av.Mirvete Çollaku nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e mbrojtëses së të dhe ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Mbrojtësja e të akuzuarit V.H., av.Mirvete Çollaku, gjithashtu ka parashtruar edhe përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të refuzohet si e pabazuar.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit V.H., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1528/2023 të datës 24.11.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren ta aprovoj si të bazuar ndërsa ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjive konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantoi, i akuzuari V.H., si dhe mbrojtësja e tij av.Mirvete Çollaku nga Prizreni dhe përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar B.K. – av.Nexhat Elshani nga Prizreni, ndërsa palët e tjera munguan andaj sesanca e kolegjive u mbajt në pajtim me nenin 390 par.4 të KPPR-së. Mbrojtësja e të akuzuarit pas elaborimit të ankesës propozoi që e njëjta të aprovohet si e bazuar e që këtë e përkrahu edhe vet i akuzuari V.H.. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar B.K. – av.Nexhat Elshani, e përkrahu ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe propozoi që e njëjta të aprovohet si e bazuar ndërsa propozoi që ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

- ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit V.H., është e bazuar, për çka aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë duhet anuluar, ndërsa ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren mbetet e pashqyrtuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësja e të akuzuarit V.H., pretendon se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë

me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale te paraparë me nenin 384 par.1 nën par.1.12 e lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit eshte i paqartë, nga arsyeja se gjykata e shkalles se pare nuk ka dhënë arsye per faktet vendimtare ndërsa arsyet qe i ka dhënë janë të paqarta dhe per faktet vendimtare ka kundërthënie te konsiderueshme ndërmjet asaj qe paraqitet ne aktgjykimin e ankimuar lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes. Gjithashtu pretendon se gjykata e shkalles se pare nuk ka vepruar ne rigjykim siç eshte udhëzuar me aktvendimin e Gjykatës se Apelit dhe nuk e ka kryer detyrën ligjore nga kërkesa e nenit 7 të KPPRK-së lidhur me detyrimin e përgjithshëm per vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, per çka aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare duhet anuluar.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtëses se të akuzuarit lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njejtat janë te bazuara, nga arseja se gjykata e shkalles se pare nuk ka dhënë arsye per faktet vendimtare ndërsa ato arsye qe i ka dhënë janë të paqarta dhe tani per tani te papranueshme, ngase nga provat e administruara dëgjimi i dëshmitarëve te njëjtit kane deklaruar se tek tani i akuzuari pas kontrollimit të të njëjtit janë gjetur vetëm 9 (nëntë) euro ndërsa ne dispozitiv te aktgjykimit ekziston konstatimi se tani i akuzuari V.H., te dëmtuarit B.K., duke përdorur forcën dhe ka kanosur seriozisht te dëmtuarit ia ka marrë shumen prej 2,500 (dymijë e pesëqind) euro, per çka edhe eshte shpallur fajtor per shkak te veprës penale Detyrimi nga neni 340 par.1 të KPRK-së.

Duke analizuar aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare, shihet se dëshmitarët F.K. dhe V.H., që të dy zyrtarë policor, te njëjtit kane deklaruar se gjate bastisje tek i akuzuari ne trup nuk ka gjetur revole siç ka pretenduar i dëmtuari e as nuk ka pasur të holla – para e gjithashtu e as nuk kane vërejtur lëndime tek i dëmtuari, ndërsa i dëmtuari ka deklaruar se i akuzuari ka përdorur forcën ndaj tij me ç’rast edhe i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore.

Në bazë të këtyre Gjykata e Apelit konstaton se janë te bazuara pretendimet ankimore te mbrojtëses se te akuzuarit V.H., edhe lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, ngase gjykata e shkalles se pare eshte bazuar ne deklaraten e te dëmtuarit i cili ka deklaruar se i akuzuari me 14.11.2015 duke përdorur forcën dhe ka kanosur seriozisht te dëmtuarin, ia ka marrë shumen prej 2,500 (dymijë e pesëqind) euro dhe ia ka kërkuar edhe 40,000 (katërdhjetë mijë) euro, duke i thënë se nëse nuk e paguan këtë shumë ka me ta mbytur familjen, mirëpo kjo nuk eshte vërtetuar me prova tjera përveç se gjykata eshte bazuar se i dëmtuari dhe i akuzuari ka bërë telefonatë më vonë mirëpo nuk ceket përmbajtja e bisedës. Ndersa i akuzuari pretendon se i ka kërkuar vetëm borxhin prej 2,000 (dymijë) euro te dëmtuarit, te cilit ia kishte dhënë para 3 viteve pra ne vitin 2012 dhe se të dëmtuarit nuk e ka kanosur me qëllim te përvetësimit te pasurisë se tij dhe vetes t’i sjellë pasuri te kundërligjshme.

Gjykata e shkallës së parë siç shihet edhe nga aktgjykimi ka administruar provat personale dhe materiale, por të njëjtat nuk i ka elaboruar ne menyre te duhur duke shqyrtuar dhe vërtetuar duke dhënë arsyet se të njëjtat çfarë relevance dhe lidhje kauzale kanë me tërë çështjen penale në përgjithësi dhe me të akuzuarin në veçanti.

Aktgjykimit i mungojnë pretendimet e mbrojtjes dhe të akuzuarit të dhëna në shqyrtim kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, e po ashtu gjykata nuk është përgjigjur në asnjë pretendim të mbrojtjes apo të akuzuarit, se përse ia falë apo nuk ia falë besimin provave mbrojtëse.

Prandaj është e domosdoshme që në rivendosje të sqarohen këto çështje se i akuzuari a e ka kryer veprën penale te detyrimin siç pretendon i dëmtuari apo kërkimin e borxhit nga i akuzuari siç pretendon i akuzuari dhe mbrojtësja e tij e pastaj te merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Kjo është më se e rëndësishme sepse nga një përfundim i tillë varet edhe ekzistenca apo mos ekzistenca e veprës penale Detyrimi nga neni 340 par.1 të KPRK-së, për të cilën i akuzuar është shpallur fajtor dhe gjykuar.

Kjo gjykatë ka gjetur se përshkrimi faktik nuk është bërë sa duhet në aktgjykim dhe se arsyetimi është i pamjaftueshëm. Pasi që aktgjykimi është në kundërshtim me dispozitat e KPPRK-së, se është e pa qartë se çfarë janë gjetjet e Gjykatës Themelore në Prizren dhe mënyra se si kjo gjykatë ka ardhur deri te përfundimet e këtilla, Gjykata e Apelit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet t'i administroj të gjitha provat dhe të njëjtat t'i vlerësoj në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim përkatës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren nuk e shqyrtoi tani për tani ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar dhe se ankesa e Prokurorisë ka të bëjë me sanksionin penal.

Nga çka u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 402 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.1494/2023, më 20.12.2023

Procemabjtësi:

Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit:

Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani

Kryetari i kolegjit:

Skender Çoçaj
